

# webertherm standard

## Ngjitës për EPS



### Përshkrimi

- **webertherm standard** është ngjitës i thatë, me bazë çimento, mbushës cilësorë dhe aditivë të përshtatshëm. Përdoret për ngjitjen e paneleve izoluese të EPS.

### Avantazhet

- Për ngjitjen e qëndrueshme të EPS në bazament
- Përgatitet dhe aplikohet lehtësisht
- Prodhuar nga lëndë të para cilësore

### Përdorimi

- **webertherm standard** përdoret për ngjitjen e paneleve izoluese prej EPS
- **webertherm standard** nuk është i përshtatshëm si shtresë përfundimtare

### Përgatitja e bazamentit

- Bazamenti ku do të aplikohen panelet e izolimit termik duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm, i pastër dhe pa prani pluhuri apo mikroorganizmash.
- Problemet e mundshme të bazamentit, duhet të riparohen para fillimit të punimeve.
- Sipërfaqja e punës duhet të jetë e mbrojtur me rrjetë skelash nga impakti i drejtpërdrejtë i erës, diellit apo shiut, këshillohet të mos kryhen punime në kushte të parpërshtatshme të motit
- Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C

### Udhezime mbi aplikimin

- Përmbajtja prej 25kg e thesit përzihet me mikser elektrik duke i shtuar gradualisht 6,5-7 l ujë sipas nevojës.
- Pas përzjerjes së parë, masa lihet në prehje për rreth 10 min dhe më pas përzjehet përsëri para se të aplikohet.
- Përzjerja e përgatitur aplikohet në pjesën e pasme të paneleve izoluese të EPS anë të mallës, në formë shiriti në anë dhe tre pika të bollshme në mes të pllakës
- Për ndërtesa me lartësi më të madhe se 3m, këshillohet përdorimi i upave të fasadës për fiksimin e paneleve në bazament, këshillohen 6 upa / m<sup>2</sup>
- Masa e përgatitur duhet të konsumohet brenda jo më shumë se 6 orësh nga përgatitja

### Veglat

Për miksim: mikser elektrik  
Për rrafshim: mallë metalike

### Jetëgjatësia

12 muaj, i magazinuar mbi paletë në zona të thata dhe pa ndikim të drejtpërdrejtë nga kushtet e motit. Duhet mbrojtur nga ngrica.

# webertherm standard G/W

Ngjitës për EPS

Tabela e të dhënave teknike

PARAMETRAT	VLERA MESATARE	
Nr.Artikulli		
Lloji i paketimit	thes letre	
Sasi për njësi	25 kg / thes 1350 kg / paletë	
Ngjyra	Gri / bardhë	
Kokërrzimi	0.6 mm	
Konsumi (në ngjitje)	6-7 kg/m <sup>2</sup>	
Të dhënat mbi konsumin janë orientuese dhe në varësi të karakteristikave të bazamentit dhe teknikës së aplikimit.		
Konsumi i ujit	6,5 - 7 l	

Treguesit fiziko-mekanikë

PARAMETRAT	VLERA MESATARE	NJËSIA MATËSE
Masa vëllimore në gjendje të shkrifët	1.3-1.4	Gr/m <sup>3</sup>
Mbjetje ↓ 180 μ	53	%
Ujë-mbajtja	99	%
Masa vëllimore e llaçit në 20 °C	1600-1700	Kg/L
Gjendja	Pluhur	

Treguesit kimikë

PARAMETRAT	VLERA MESATARE	NJËSIA MATËSE
Lagështira	0.10	%
Aditivë	1.5	

\*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara.



SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k

Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq

Vore • Shqiperi

www.saint-gobain.com

NIPT : L61822023H